



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 234 prot.

Durrës, më 30.03.2026

SHPALLJE

PËR 6 (GJASHTË) VENDE VAKANTE

Bazuar në ligjin 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, ligjin nr.10129 datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile" i ndryshuar dhe V.K.M. nr.75 datë 06.02.2026 " Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të numrit të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë Prefektit të Qarkut" shpall thirrjen për dorëzimin e dokumentave të aplikantëve për t'u marrë në shqyrtim në bazë të nenit 66 të ligjit 10129 datë 11.05.2009 "Për gjendjen civile"

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Zbaton metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
- Administrojnë arkivin e regjistrave dhe të akteve të gjendjes civile.
- Lëshojnë certifikatat të shërbimit të gjendjes civile për dokumente që administron vetë zyra, me kërkesë të personit të interesuar ose të zyrës së gjendjes civile nëbashki /njësi administrative.
- U japin të dhëna institucioneve shtetërore dhe personave juridikë privatë, sipas mënyrës të përcaktuara me ligj.
- Pranojnë dhe shpërndajnë në zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative njoftimet, që vijnë nga institucionet e tjera shtetërore dhe anasjelltas.

Kritere për pozicionet vakante:

- Të ketë përfunduar arësimin e lartë.
- Kandidatët që aplikojnë të vijnë nga brenda sistemit të shërbimit të gjendjes civile në njësitë administrative të qarkut Durrës.

Dokumentacioni , mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të paraqesin zyrtarisht, brenda datës 08.04.2026, pranë Prefektit të Qarkut Durrës dokumentat e mëposhtëm:

- Kërkesë për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- C.V.;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Fotokopje e diplomës së arësimit të lartë dhe listës së notave të noterizuar;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- Vërtetim i gjendjes shëndetësore (raport i aftësisë në punë);
- Fotokopje të librezës së punës të noterizuar (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor penal;
- Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë emaili) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit (vërtetim banimi);
- Deklaratë e konfliktit të interesit;

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikimin e kandidatit.

Njoftimi dhe komunikimi për kandidatët do të jetë nëpërmjet adresës së emailit të kandidatit.

PREFEKTI

ADRIAN GURRA

